



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**DRAFT 2
VERSION 1**

14 TETOR 2013

VENDIM

Nr. ___, datë _____ 2013

**“KËRKESAT E POSAÇME, KUSHTET DHE RREGULLAT PËR SHQYRTIMIN DHE TRANSFERIMIN
E LEJEVE TË MJEDISIT ”***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 11, të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

- 1.** Miratimin e kërkesave të posaçme, kushteve dhe rregullave për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi, transferimin e tyre nga një subjekt tek tjetri, si dhe përcaktimin e rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.
- 2.** Miratimin e Aneksëve për Formularin e Kërkesës për lejet e Tipit A, B dhe C, si dhe Formatin Standard të Lejes për lejet e tipit A, B dhe C bashkëlidhur këtij vendimi.

PËRKUFIZIME

Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim që u jepet përkatësisht nga:

- a)** Ligji nr.10448, datë 14. 7. 2011 “Për lejet e mjedisit”;
- b)** Ligji nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- c)** Ligji nr.10081 datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- d)** Ligji nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- e)** Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;

* Ky vendim transponon pjesërisht Direktivën 2008/1/KE “Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes” e ndryshuar. CELEX nr. 32008L0001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian. seria L 332, 28.12.2000, p. 81, nr. 24, date 29.1.2008, faqe 8-29.

- f) Ligji nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- g) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.223, datë 13.3.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit”;
- h) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.xxx, datë xx.xx.2013 “Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit”.

KREU I SEKSIONI 1

PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A, B DHE C

1. Kërkuesi dërgon në QKL kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e kërkuar në Formularin e Kërkesës për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10081 datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me paragrafin 2, të këtij seksioni. Kërkesa për leje mjedisi të tipit A, B dhe C përgatitet në përputhje me Formularin e Kërkesës përcaktuar përkatësisht në anekset 1, 2 dhe 3 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi të tipave A, B dhe C kalon në këto faza të njëpasnjëshme:
 - a) QKL përcjell kërkesën në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
 - b) AKM verifikon saktësinë e informacionit, shqyrton dhe i jep mendimin e argumentuar Ministrit për dhënien ose jo të lejes;
 - c) AKM i siguron publikut informacionin për instalimet e kategorive A dhe B dhe siguron përfshirjen e këtij informacioni në sistemin e informacionit mjedisor sipas përcaktimeve të ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
 - d) Ministri firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato janë verifikuar, shqyrtuar dhe përgatitur nga AKM;
 - e) AKM dërgon në QKL aktin e miratimit ose të refuzimit të kërkesës për leje mjedisi;
 - f) QKL lëshon lejet e mjedisit e tipit A, B dhe C ose bën refuzimin sipas rastit;
 - g) QKL publikon lejet në Rregjistrin Kombëtar të Licensave dhe Lejeve.
3. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi të tipit C, kalon në të gjitha fazat e sipërpërmendura me të vetmin ndryshim që në vend të AKM do të jetë ARM që do të luajë rolin dhe kompetencat referuar ligjit për lejet e mjedisit, ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe këtij vendimi.

SEKSIONI 2 KËRKESAT PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A, B DHE C

1. Formulari i kërkesës për leje mjedisi të tipit A, B dhe C të paktën duhet të përmbajë:
 - a. Emrin, adresën dhe numrin e telefonit të kërkuesit, si dhe adresën ku duhet të dërgohet korrespondenca lidhur me këtë kërkesë, nëse kjo është e ndryshme nga adresa e kërkuesit;
 - b. Adresën e vendodhjes së instalimit;
 - c. Numrin kadastral të vendodhjes, hartën treguese me numrin e pasurisë dhe sipërfaqen në ha;
 - d. Një hartë ose një skicë që tregon vendodhjen dhe pozicionimin e instalimit në atë vendodhje;
 - e. Kategorinë e resursit (në rast tokë bujqësore) dhe bonitetin;
 - f. Emrin e bashkësive ose të komunës ku gjendet vendodhja e instalimit;
 - g. Përshkrimin e instalimit dhe të veprimtarive që do të kryhen në instalim, dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me to dhe që do të kryhet në të njëjtën vendodhje me këtë instalim dhe do të ketë një lidhje teknike me veprimtaritë e përmendura fillimisht dhe që mund të ketë një ndikim në shkarkimet e instalimit dhe ndotjen e prodhuar prej tij;

- h. Raportin mbi kushtet e vendodhjes se instalimit. Ky raport identifikon ne mënyrë të vecantë çdo substancë që ndodhet mbi, në ose nën toke qe mund te përbëjë rrezik për ndotje;
 - i. Skemat me rradhën e proceseve te prodhimit qe synohet te përdoren;
 - j. Informacion mbi lendet e para dhe materialet ndihmese, përfshirë ujin, substanca të tjera dhe energjine qe do të përdoret ose gjenerohet nga instalimi;
 - k. Informacion mbi natyrën, sasi të dhe burimet e shkarkimeve nga instalimi ne të gjithë përbërësit e mjedisit, si dhe identifikimin dhe përshkrimin e çdo efekti te rëndësishëm te shkarkimeve ne mjedis;
 - l. Informacion mbi teknologjinë e propozuar dhe teknika te tjera për parandalimin, ose kur kjo nuk është e mundur, pakësimin e shkarkimeve nga instalimi;
 - m. Informacion mbi masat e propozuara dhe metodat qe do të zbatohen për monitorimin e shkarkimeve të instalimit;
 - n. Përshkrimin e masave qe do të ndërmerren për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve te gjeneruara nga instalimi, kur është e nevojshme;
 - o. Përshkrimin e masave te tjeta te propozuara për tu ndërmarrë për të përmbushur parimet e pergjithshme të përcaktuara ne nenin 9 te ligjit për lejet e mjedisit;
 - p. Alternativat kryesore te metodave dhe teknikave të prodhimit, në qoftë se ekzistojnë, që kerkuesi i ka studiuar;
 - q. Çdo informacion tjetër qe kerkuesi i lejes kërkon te merret parasysht gjatë shqyrtimit të kërkesës;
 - r. Përmbledhje jo-teknike të informacionit te referuar në pikën 1 sa më sipër.
2. Kërkesa për lejen e mjedisit te tipit A përfshin edhe çdo informacion te rëndësishëm te përfutur ose konkluzionet e arritura ne lidhje me instalimin nga vlerësimi i ndikimit ne mjedis, ne rastet kur per instalimin kërkohet një Raport i Vlerësimit te Ndikimit në Mjedis në përputhje me ligjin për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis.
3. Ne rastet kur për instalimin kërkohet përgatitja e një Raporti mbi Sigurinë ne përputhje me legjislacionin per parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, raporti mbi sigurinë mund te përfshihet ose t'i bashkëngjitet formularit të kërkesës për leje mjedisi.
4. Sipas rastit, kërkesa për leje mjedisi e tipit A për një instalim ekzistues shoqërohet me:
- a. një kopje të Lejes, Licensës apo autorizimit të ujit të dhënë per kete instalim ne përputhje me legjislacionin për menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
 - b. një kopje të Lejes, Licensës apo autorizimit të ajrit të dhënë per kete instalim në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e ajrit;
 - c. një kopje të Lejes, për menaxhimin e mbetjeve, të dhënë për këtë instalim në përputhje me ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
 - d. një kopje të lejes, Licenses apo Autorizimit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme të dhënë për këtë instalim në përputhje me legjislacionin për administrimin e mbetjeve të rrezikshme;
 - e. një kopje te çdo leje mjedisi, autorizimi ose license ekzistuese të dhënë për këtë instalim;
 - f. një kopje të Lejes së Zhvillimit, Ndërtimit, ose Infrastrukturës të dhënë për këtë instalim, siç parashikohet nga legjislacioni për Planifikimin e Territorit në Republikën e Shqipërisë.
5. QKL e konsideron kërkesën për leje mjedisi të tipit A,B,C si te vlefshme, vetëm kur kerkuesi ka kryer ose provon qe ka kryer pagesen e tarifës sic parashikohet nga ligji per lejet e mjedisit.

KREU II

KËRKESA TË POSAÇME, DHËNIA E MENDIMIT DHE MARRJA E VENDIMIT PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A

Seksioni 1

Kërkesat e posaçme për përcaktimin e kushteve të lejeve të mjedisit të tipit A

1. AKM sigurohet që për leje mjedisi të tipit A për çdo instalim të përfshihen kushtet e përmendur më poshtë për:
 - a) Vlerat kufi të shkarkimit për ndotësit, në menyre të vecante të atyre ne shtojcen 2, të ligjit nr.10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit”, që parashikohen te shkarkohen ne sasi te konsiderueshme nga instalimi ne fjale. Vlerat kufi të shkarkimeve përcaktohen duke u mbeshtetur në natyrën e ndotësve dhe potencialin e tyre për t’u transferuar nga një përbërës i mjedisit në një tjetër;
 - b) Vlerat kufi të shkarkimeve sipas percaktimit të paragrafit 1(a), që zbatohen për grupet e ndotësve dhe jo per ndotës te vecante, kur kjo është e mundur;
 - c) Vlerat kufi te shkarkimeve, sipas percaktimit te paragrafit 1 (a), që zbatohen në piken ku shkarkimet dalin nga instalimi pavarësisht hollimit që mund t’i ndodhe atyre në distancë nga kjo pikë. Ne rastin e shkarkimeve jo te drejtpërdrejta në ujë, gjatë llogaritjes së vlerave kufi te shkarkimeve te instalimit ne fjale, merrret ne konsiderate edhe perdorimi i nje instalimi për trajtimin e ujit me kusht qe te garantohet nje nivel i njejte i mbrojtjes se mjedisit ne teresi dhe qe nje gje e tille te mos shkaktojë nivele me të larta ndotje në mjedis;
 - d) Kur standardet teknike për funksionimin e një instalimi, janë vendosur në perputhje me legjislacionin për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve ose te zhurmave apo akte te tjera në fuqi që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, ato vleresohen si vlerat kufi maksimale te shkarkimeve, sipas përcaktimit të paragrafit 1 (a);
 - e) Në përputhje me paragrafin 1(g) përcaktimi i vlerave kufi të shkarkimeve referuar gjermës (a) te ketij paragrafi mbeshtetet në TMD për llojin e instalimit në fjalë, por jo në ndonjë teknike ose teknologji të veçantë dhe në çdo rast merr parasysh karakteristikat teknike te instalimit, vendndodhjen e tij gjeografike dhe kushtet e mjedisit ne ate zonë;
 - f) Vlerat kufi te shkarkimeve sipas percaktimit te paragrafit 1(a), për instalimet e referuara ne pikat A.7.7(b) dhe 7.8 te shtojces 1, te ligjit nr.10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit”, mbështeten në vleresime praktike të përshtatshme për këto kategori instalimesh;
 - g) Kur standardi i cilësisë së mjedisit për një instalim përcakton vlera shkarkimesh më të ulëta se ato te vendosura ne vlerat kufi te shkarkimeve referuar në paragrafin 1(e), atëherë per instalimin zbatohen vlerat kufi të shkarkimeve të percaktuara nga standardi i cilësisë se mjedisit;
 - h) Lendfilli që mbulohet nga pjesa 5.2(a) e Shtojcës 1 të ligjit nr.10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit” konsiderohet se plotëson kërkesat teknike të këtij ligji, ne qoftë se ai plotëson kërkesat teknike për lendfille të tilla, sic përcaktohet edhe në legjislacion përkatës për lendfilltet;
 - i) Sipas rastit, vlerat kufi të shkarkimeve sipas përcaktimit të paragrafit 1(a), mund të plotesohen ose zëvendësohen nga parametra te njejte ose masa teknike.

2. Leja e mjedisit e tipit A përfshin gjithashtu kushte që:
 - a) synojnë të minimizojne ndotjen në distancë të largët ose ndotjen ndërkuftare;
 - b) sigurojnë efektin akumulative nga instalime ndotëse ekzistuese të tjera;
 - c) sigurojnë një nivel të larte të mbrojtjes së mjedisit në tërësi;
 - d) sigurojnë mbrojtjen e tokës në qoftë se është e nevojshme;
 - e) sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore në qoftë se është e nevojshme;
 - f) sigurojnë kushte të përshtatshme për reduktimin e ndotjes nga zhurma dhe drita;
 - g) sigurojnë menaxhimin e duhur të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi në qoftë se është e nevojshme;
 - h) përcaktojnë kërkesa të përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve që specifikojnë metodologjinë dhe frekuencën e matjeve dhe procedurën e shqyrtimit, dhe qe sigurojne se zoteruesi i lejes i jep AKM dhe ISHM)të dhënat e kërkuara për të kontrolluar përmbushjen e kushteve te lejes se mjedisit te tipit A. Gjithsesi, për instalimet e referuara ne Pjesën A 7.8.(a, b dhe c) ne shtojcen 1 te ligjit nr.10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit”, kërkesat e kësaj pike merren parasysh edhe kostot dhe përfitimet;
 - i) janë te përshtatshme për periudhat kur instalimi nuk funksionon normalisht dhe ekziston rreziku i një ndikimi në mjedis. Këto kërkesa kanë të bëjnë me fillimin e operacioneve, rrjedhjet, keqfunksionimet, ndalesat e përkohshme dhe ndalimin përfundimtar të operacioneve;

- j) përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë përpara vënies në punë të instalimit, për të shmangur çdo rrezik nga ndotja dhe të kthejnë vendodhjen e instalimit në gjendje të kënaqshme;
 - k) përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë pas ndalimit përfundimtar të operacioneve të instalimit;
 - l) kërkojnë që operatori t'i sigurojë rregullisht AKM dhe ISHM rezultatet e vetë-monitorimit të shkarkimeve;
 - m) kërkojnë që operatori të informojë pa vonesë AKM dhe ISHM, për çdo incident ose aksident që ndikon apo mund të ndikojë seriozisht në mjedis; dhe
 - n) Përveç sa mësipër, kur është e nevojshme, kërkojnë specifikisht nga AKM për arritjen e qëllimeve të këtij vendimi.
3. Formati Standart për Lejen e mjedisit të tipit A nuk e përfshin vlerën kufi për shkarkimet e drejtpërdrejta të gazrave serrë në qoftë se shkarkimet e gazrave serrë nga një instalim specifikohen në ndonjë akt tjetër për skemat e tregtimit për shkarkimet e gazrave serrë për çdo veprimtari që kryhet në atë instalim, dhe në qoftë se nuk është e nevojshme të sigurohet që nuk do të shkaktohet ndotje e konsiderueshme e mjedisit. Dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen mbi instalimet që përjashtohen përkohësisht nga kjo skemë.
4. Formati Standart për Lejen e mjedisit të tipit A mund të përmbajë edhe kushte të tjera sic kërkohet nga akte ligjore/nënligjore të tjera në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në tërësi. Në asnjë rast këto kushte nuk duhet të bien ndesh me kërkesat e ligjit nr.10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" dhe të këtij vendimi.

Seksioni 2

Shqyrtimi i kërkesës për leje mjedisi të tipit A

1. QKL brenda 2 ditëve pas marrjes së kërkesës për leje mjedisi të tipit A, ia përcjell atë në mënyrë elektronike AKM-së e cila njofton menjëherë me shkrim Kërkuesin për marrjen në rregull të kërkesës.
2. AKM brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës për leje mjedisi, dërgon një kopje të kërkesës në institucionet e mëposhtme duke u theksuar edhe afatin prej 15 ditësh për dërgimin e mendimit të tyre:
 - a) Ministrive të linjës të cilat janë përgjegjëse në planifikimin e territorit, mbrojtjen e shëndetit publik, tokën bujqësore, zhvillimin e ekonomisë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës publike;
 - b) bashkine ose komunën, në territorin e se cilës ndodhet instalimi;
 - c) Këshillin e Qarkut;
 - d) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit;
 - e) Agjencinë e basenit ujëmbledhës të lumit pranë të cilit është vend-ndodhja e instalimit;
 - f) Ndërmarrjen përkatëse të ujësjellës kanalizimeve, në rast se në atë rrjet kanalizimesh mund të shkarkohet ndonjë substancë si rezultat i funksionimit të instalimit;
 - g) Administratën e Zonës së Mbrojtur kur funksionimi i instalimit mund të shkaktojë një shkarkim që mund të ndikojë në atë zonë.
3. AKM brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit A, në qoftë se e konsideron të nevojshme, kërkon me shkrim nga kërkuesi i lejes informacione të tjera shtesë nëpërmjet QKL. Kërkesa e saj specifikon arsyen ose arsyet përse kërkohet ky informacion shtesë.
4. Kërkuesi, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, dërgon në AKM informacionin shtesë të kërkuar në paragrafin 3. Kërkuesi i lejes se mjedisit të tipit A dhe AKM mund të zgjatën këtë periudhë me një marreveshje të perbashkët me shkrim.
5. AKM konsideron që kërkuesi i lejes së mjedisit ka tërhequr vetë kërkesën dhe e informon kërkuesin me shkrim për këtë nëpërmjet QKL, në qoftë se kërkuesi i lejes se mjedisit nuk dërgon informacionin shtesë të kërkuar referuar pikën 3, brenda periudhës kohore të përcaktuar në paragrafin 4.
6. AKM pas marrjes së informacionit shtesë të përcaktuar në paragrafin 3, ia dërgon menjëherë atë autoriteteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij Seksioni.
7. AKM dhe autoritetet e përcaktuara në paragrafin 2 më sipër, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për leje mjedisi mund të inspektojnë instalimin dhe/ose vend-ndodhjen e tij me qëllim verifikimin e informacionit të dhënë nga kërkuesi i lejes.

8. Autoritetet e përcaktuara në pikën 2, në përputhje me fushën e kompetencave të tyre, brenda 15 diteve, pas periudhës së përcaktuar në paragrafin 2 më sipër, ose periudhën e përcaktuar në paragrafin 7 kur është inspektuar instalimi dhe/ose vendodhja e tij me qëllim verifikimin e informacionit të dhënë nga kërkuesi i lejes, i japin AKM me shkrim ose në rrugë elektronike, komentet për kërkesën për leje mjedisi.
9. AKM konsideron se autoritetet e përcaktuara në paragrafin 2 më sipër, nuk kanë komente për kërkesën, në qoftë se asnjë prej tyre nuk dërgon mendimet/ komentet e tij brenda këtij afati.

Seksioni 3

Verifikimi i informacionit dhe lëshimi i lejeve të mjedisit të tipit A

1. AKM përpara se të japë mendimin e argumentuar tek Ministri merr në konsideratë :
 - a) mendimet e marra brenda periudhës së lejuar nga autoritetet përkatëse sipas dispozitave të këtij vendimi;
 - b) mendimet e marra brenda periudhës së lejuar, nga cdo përfaqësues i publikut sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
 - c) kur është e nevojshme, informacionet ose përfundimin e nxjerrë për atë instalim nga vlerësimi i ndikimit në mjedis i kryer për të në zbatim të ligjit nr.10440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. AKM kryen procedurën e verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit brenda 15 ditëve nga data e informimit të kerkuesit që kërkesa për leje mjedisi është marrë në rregull sipas parashikimeve të këtij vendimi.
3. Periudha kohore referuar në pikën 2 mësipër mund të zgjatet për aq kohe sa AKM dhe kërkuesi bien dakord me shkrim, por në asnjë rast ajo nuk mund të zgjatet më shumë se ---- ditë.
4. Kerkuesi, mund të ankimojë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative në qoftë se AKM nuk vepron brenda afateve të përcaktuara në këtë Seksion.
5. AKM i jep mendim të argumentuar me shkrim Ministrin për dhënien ose jo të lejes me kushte të detajuara, brenda 4 ditëve pasi ka arritur në përfundimet e saj.
6. Ministri brenda 2 ditëve firmos aktin e miratimit të lejes së mjedisit të tipit A, pasi ato janë shqyrtuar dhe përgatitur me kushte të detajuara nga AKM.
7. AKM i përcjell në mënyrë elektronike QKL-së aktet për refuzimin ose miratimin e kërkesës për leje mjedisi.
8. Pas miratimit përfundimtar të Lejes nga Ministri si më sipër, QKL lëshon lejen e mjedisit dhe brenda ___ditëve e publikon lejen në Rregjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licensave dhe njofton Ministrinë/AKM.
9. AKM brenda tre ditësh nga lëshimi i lejes nga QKL i dërgon informacionin mbi dhënien e Lejes njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe institucioneve të konsultuara.
10. Ministria/AKM regjistron lejet në bazën e të dhënave për lejet.

KREU III

KËRKESA TË POSAÇME, DHËNIA E MENDIMIT DHE MARRJA E VENDIMIT PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B

Seksioni 1

Kërkesat e posaçme për përcaktimin e kushteve të lejeve të mjedisit të tipit B

1. AKM sigurohet që për leje mjedisi të tipit B për çdo instalim të përfshihen kushtet e përmendur më poshtë për:
 - a) Vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, në mënyrë të veçantë të atyre të listuar në shtojcën 2, të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit", që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi, që përcaktohen duke patur parasysh natyrën dhe potencialin e tyre për të transferuar ndotjen nga një përbërës i mjedisit në një tjetër;
 - b) Vlerat kufi të shkarkimeve që kërkohen në paragrafin 1(a), kur është e mundur, mund të zbatohen për grupet e ndotësve dhe jo për ndotës të veçantë;
 - c) Vlerat kufi të shkarkimeve që përcaktohen në përputhje me pikën 1(a) zbatohen në pikën ku shkarkimet dalin nga instalimi, dhe nuk marrin parasysh ndonjë hollim që mund t'i bëhet atyre. Gjatë përcaktimit të vlerave kufi të shkarkimeve në ujë të atij instalimi, merret parasysh efekti që mund të ketë një impjant për trajtimin e ujit, me kusht që të garantohet i njëjti nivel mbrojtje për mjedisin në tërësi dhe me kusht që një gjë e tillë nuk kon në nivele më të larta të ndotjes së mjedisit;
 - d) Standardet teknike të shkarkimeve të një instalimi, të caktuara në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve apo të zhurmave ose akte të tjera në fuqi që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, për qëllime të paragrafit 1(a), konsiderohen si vlera maksimale kufi të shkarkimeve;
 - e) Kur një standard i cilësisë së mjedisit kërkon që vlerat kufi të shkarkimeve të një instalimi të jenë më të ulta se ato që janë vendosur sipas përcaktimit të paragrafit 1(d), atëherë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara sipas paragrafit 1(a) kërkojnë vlerat kufi më të ulta të shkarkimeve;
 - f) Kur është e përshtatshme, vlerat kufi të shkarkimeve sipas përcaktimit të paragrafit 1(a), mund të shtohen ose zëvendësohen nga parametra të njëjtë ose masat teknike.

2. Leja e mjedisit e tipit B përfshin gjithashtu kushte që:
 - a) sigurojnë se nuk shkarkohet asnjë ndotje e konsiderueshme, në veçanti me anë të zbatimit të praktikave më të mira;
 - b) sigurojnë mbrojtjen tokës, nëse është e nevojshme;
 - c) sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore, nëse është e nevojshme;
 - d) sigurojnë menaxhimin e përshtatshëm të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi, nëse është e nevojshme;
 - e) përcaktojnë masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e aksidenteve dhe minimizimin e pasojave të tyre, nëse është e nevojshme;
 - f) përcaktojnë kërkesa të përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve, duke përcaktuar metodologjinë dhe frekuencën e matjeve, procedurën e vlerësimit, dhe të sigurojnë se zoteruesi i lejes i jep AKM dhe ISHM të dhënat e kërkuara për të kontrolluar përmbushjen e kushteve të lejes së mjedisit të tipit B;
 - g) kanë të bëjnë me periudhat kur instalimi nuk funksionon normalisht dhe ka një rrezik real që mjedisi të ndikohet gjatë kësaj periudhe. Në mënyrë të veçantë, përfshihen kushte që kanë të bëjnë me fillimin e funksionimit, rrjedhjet e pa kontrolluara, keqfunksionimet, ndalesat e perkohshme dhe ndalimin përfundimtar të veprimtarisë;
 - h) përcaktojnë hapat që duhen marrë përpara vënies në punë të instalimit;
 - i) përcaktojnë hapat që duhen marrë pas ndalimit përfundimtar të funksionimit të instalimit në mënyrë që të evitohet çdo rrezik ndotje dhe vendi ku ndodhet instalimi të kthehet në gjendje mjedisore të pranueshme;
 - j) i kërkojnë operatorit të informojë rregullisht AKM dhe ISHM, mbi të dhënat e monitorimit të shkarkimeve;
 - k) i kërkojnë operatorit të informojë pa vonesë AKM dhe ISHM, për çdo incident ose aksident që ndikon ose mund të ndikojë në mjedis; dhe
 - l) kërkesa të tjera të posaçme që vleresohen si të nevojshme nga AKM për arritjen e qëllimeve të këtij vendimi.

3. Për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B, mund të kërkohen edhe kushte të tjera të percaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në tërësi. Në asnjë rast, keto kushte nuk mund të bien ndesh me kushtet e parashikuara në ligjin nr.10448, date 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe në këtë vendim.

Seksioni 2

Shqyrtimi i kërkeses për leje mjedisi të tipit B

1. Pas marrjes së kërkeses për leje mjedisi të tipit B, QKL brenda 2 ditësh e përcjell në mënyrë elektronike në AKM, e cila njofton menjëherë me shkrim kerkuesin për marrjen në rregull të kërkesës.
2. AKM, brenda 2 ditëve nga marrja e kërkeses për leje mjedisi të tipit B, dërgon një kopje të kërkeses institucioneve të listuara më poshtë, duke u theksuar afatin 15 ditor për dhënien e mendimeve të tyre:
 - a) Ministrive të linjës të cilat janë përgjegjëse në planifikimin e teritorrit, mbrojtjen e shëndetit publik, tokën bujqësore, zhvillimin e ekonomisë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës publike;
 - b) bashkine ose komunën, në territorin e se cilës ndodhet instalimi;
 - c) Këshillin e Qarkut;
 - d) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit;
 - e) Agjencinë e basenit ujëmbledhës të lumit pranë të cilit është vend-ndodhja e instalimit;
 - f) Ndërmarrjen përkatëse të ujësjellës kanalizimeve, në rast se në ato rrjet kanalizimesh mund të shkarkohet ndonjë substancë si rezultat i funksionimit të instalimit;
 - g) Administratën e Zonës së Mbrojtur kur funksionimi i instalimit mund të shkaktojë një shkarkim që mund të ndikojë në ate zonë.
3. AKM, brenda 2 ditëve nga marrja e kërkeses për leje mjedisi të tipit B, kërkon me shkrim informacione të tjera shtesë nëpërmjet QKL, nga kërkuuesi i lejes në qoftë se e konsideron këtë të nevojshme. Në kërkesë përcaktohet arsyeja ose arsyet përse kërkohet ky informacion.
4. Kërkuuesi i lejes së mjedisit dërgon informacionin shtesë në AKM sipas përcaktimit të pikës 3, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Kërkuuesi i lejes së mjedisit dhe AKM, mund të zgjasin këtë periudhë për aq kohë sa bihet dakord me shkrim mes tyre.
5. Në qoftë se kërkuuesi i lejes së mjedisit nuk dërgon informacionin shtesë të kërkuar referuar paragrafit 3, brenda periudhës kohore referuar në paragrafin 4, AKM e konsideron kërkesën për leje mjedisi si të tërhequr nga vetë kërkuuesi dhe nëpërmjet QKL informon kërkuuesin me shkrim për këtë vlerësim.
6. Pas marrjes së informacionit shtesë referuar në paragrafin 3, AKM ia dërgon menjëherë këtë informacion shtesë autoriteteve të percaktuara në paragrafin 2 të këtij Seksioni.
7. AKM dhe autoritetet e percaktuara në paragrafin 2 më sipër, brenda afatit prej 15 ditësh nga marrja e kërkeses për leje mjedisi mund të inspektojnë instalimin dhe/ose vend-ndodhjen e tij me qëllim verifikimin e informacionit të dhënë nga kërkuuesi i lejes.
8. Autoritetet e percaktuara në paragrafin 2, në përputhje me fushën e kompetencave të tyre, brenda 15 ditëve, pas periudhës së percaktuar në paragrafin 2 më sipër, ose periudhës së percaktuar në paragrafin 7 kur është inspektuar instalimi dhe/ose vendodhja e tij me qëllim verifikimin e çdo informacioni të dhënë nga kërkuuesi i lejes, i japin AKM-se me shkrim ose elektronikisht komentet për kërkesën për leje mjedisi.
9. AKM konsideron se autoritetet e percaktuara në paragrafin 2 më sipër nuk kanë komente mbi kërkesën për leje mjedisi, në qoftë se asnjëri prej tyre nuk dërgon komente mbi kërkesën për leje mjedisi në AKM brenda kësaj periudhe.

Seksioni 3

Verifikimi i informacionit dhe lëshimi i lejeve të mjedisit të tipit B

1. AKM përpara se të japë mendimin e argumentuar tek Ministri merr në konsideratë:
 - a) mendimet e marra brenda periudhës se lejuar nga autoritetet perkatese sipas percaktimeve të këtij vendimi;
 - b) mendimet e marra brenda periudhës se lejuar, nga cdo përfaqësues i publikut sipas percaktimeve të këtij vendimi; dhe
 - c) kur eshte e nevojshme, informacionet ose përfundimin e nxjerrë për atë instalim nga vlerësimi i ndikimit ne mjedis i kryer për të në zbatim te ligjit nr.10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.
2. AKM kryen procedurën e verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit brenda ----- ditë nga data e informimit te kerkuesit që kërkesa për leje mjedisi është marrë në rregull sipas percaktimeve të këtij vendimi.
3. Periudha kohore referuar ne paragrafin 3 mësipër mund te zgjatet për aq kohe sa AKM dhe kerkuesi bien dakord me shkrim, por në asnje rast ajo nuk mund te zgjatet më shume se ----- ditë pune.
4. Kerkuesi, mund te ankimoje sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative në qoftë se AKM nuk vepron brenda afateve të percaktuara në këtë Seksion,.
5. AKM i jep mendim të argumentuar me shkrim Ministrin për dhënien ose jo të lejes me kushte të detajuara, brenda ____ ditëve pasi ka arritur në përfundimet e saj.
6. Ministri brenda 2 ditëve firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit B, pasi ato janë shqyrtuar dhe përgatitur me kushte të detajuara nga AKM.
7. AKM i përcjell elektronikisht QKL aktet për refuzimin ose miratimin e kërkesës për leje mjedisi..
8. Pas miratimit përfundimtar të Lejes nga Ministri si më sipër, QKL lëshon lejen e mjedisit dhe brenda ___ditëve e publikon lejen në Rregjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licensave dhe njofton Ministrinë/AKM,
9. AKM brenda tre ditësh nga lëshimi i lejes nga QKL i dërgon informacionin mbi dhënien e Lejes njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe institucioneve të konsultuara.
10. Ministria/AKM regjistron lejet në bazën e të dhënave për lejet.

KREU IV

NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMEVE TË TIPIT A DHE B.

Section 1

Ndryshim i propozuar në funksionimin e një instalimi të tipit A dhe B.

1. Kur operatori i një instalimi te tipit A dhe B, propozon të kryejë një ndryshim në funksionimin e këtij instalimi, ai njofton AKM-në të paktën 14 ditë përpara kryerjes së këtij ndryshimi.
2. Njoftimi i parashikuar në piken 1, behet me shkrim dhe përmban një përshkrim të ndryshimit të propozuar në funksionimin e instalimit.
3. AKM, lajmëron për çdo njoftim të marrë sipas paragrafit 1. Ky lajmërim i bëhet operatorit brenda pesë ditëve nga marrja e njoftimit të përcaktuar në paragrafin 1.
4. AKM, në qoftë se është e nevojshme përditëson kushtet e përfshira në Formatin standart të lejes për operatorin përkatës.
5. AKM, kur vendos të përditësojë kushtet e lejes së mjedisit te perfshira ne Formatin standart te lejes, njofton me shkrim operatorin duke specifikuar përditësimin e kushteve të lejes dhe datën apo datat kur ky përditësim bëhet efektiv dhe i vlefshëm. AKM në të njëjtën kohë njofton elektronikisht QKL-në dhe regjistron një kopje të lejes së përditësuar të tipit A dhe B në regjistrin përkatës në përputhje me ligjin për lejet e mjedisit si dhe me këtë vendim.

Seksioni 2

Ndryshim thelbësor i propozuar në funksionimin e një instalimi të tipit A dhe tipit B

1. AKM, kur vlereson se ndryshimi i propozuar në funksionimin e një instalimi të tipit A dhe/ose të Tipit B, sipas njoftimit të bërë nga operatori në zbatim të Seksionit 1 të këtij Kreu, mund të shkaktojë një ndryshim thelbësor të funksionimit të instalimit, AKM informon operatorin se duhet të kërkojë një ndryshim në kushtet e lejes, në mënyrë që instalimi të vazhdojë të funksionojë mbas këtij ndryshimi.
2. Dispozitat e Kreut II për Tipin A (Seksioni 1,2,3) dhe Kreut III (Seksioni 1,2,3) për tipin B zbatohen edhe për kërkesen për ndryshim të kushteve të lejes. Në zbatim të këtij paragrafi fjalët “kërkesë për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” lexohen “kërkesë për ndryshime në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.
3. Kërkesa për ndryshim të kushteve të lejes, bëhet për ato pjesë të instalimit që mund të ndikohen nga ndryshimet e propozuara dhe për ato aspekte të përfshira në Formularin e Kërkesës që mund të ndikohen nga ndryshimi i propozuar.
4. AKM, kur vendos të ndryshojë kushtet e lejes së mjedisit të përfshira në Formatin standart të lejes, të tipit A dhe/ose të tipit B, njofton me shkrim operatorin duke specifikuar ndryshimet në kushtet e lejes dhe datën ose datat kur këto ndryshime bëhen efektive dhe të vlefshme. AKM informon në të njëjtën kohë në rrugë elektronike edhe QKL-në dhe regjistrin një kopje të lejes së përditësuar të tipit A dhe/ose tipit B në regjistrin përkatës në përputhje me ligjin për lejet e mjedisit si dhe me këtë vendim.
5. AKM vlerëson një kërkesë për ndryshim në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A dhe/ose tipit B si të vlefshme vetëm kur kërkuar ka paguar ose provon që ka paguar tarifën e parashikuar në ligjin për lejet e mjedisit.

KREU V

NJOFTIMI PUBLIK PËR KERKESËN PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A DHE B

Seksioni 1

Njoftimi publik për kërkesën për leje mjedisi të tipit A dhe B

1. AKM brenda 15 ditëve nga marrja e formularit të kërkesës për lejen e mjedisit të tipit A dhe/ose B, i bën kërkesat për leje mjedisi të disponueshme për komente nga publiku përpara marrjes së vendimit.
2. Kërkuar publikon një njoftim mbi këto kërkesë për leje mjedisi, në të paktën një gazetë të zones ku ndodhet instalimi dhe në një gazetë kombëtare. Njoftimi publikohet në të paktën dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.
3. Kërkuar dergon një kopje të publikimit të njoftimit të përcaktuar në paragrafin 2, së bashku me të gjithë dokumentat e tjerë të nevojshëm për të aplikuar në QKL.
4. Kërkuar i dergon një kopje të njoftimit të përcaktuar në paragrafin 2 mësipër AKM-së, e cila e vendos atë në faqen e saj të internetit.
5. Kur kërkuar i kërkohet të publikojë një njoftim sipas këtij Seksioni, si dhe i kërkohet të publikojë një njoftim sipas nenit 16 të ligjit nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” ai mund të zgjedhë, të publikojë një njoftim të vetëm që i plotëson kërkesat e ligjit për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe këtij vendimi.
6. Njoftimi i kërkuar sipas paragrafit 2:
 - a) tregon nëse kërkesa është për një leje të re mjedisi të tipit A ose B ose një kërkesë për një rishikim të lejes ose të ndonjërit prej kushteve të përcaktuara në këto leje;
 - b) tregon emrin e kërkuar;
 - c) tregon adresën e vend-ndodhjes së instalimit;
 - d) përshkruan shkurtimisht veprimtaritë që parashikohet të zhvillohen në instalim;
 - e) përfshin një përshkrim të elementëve të listuara në formularin e kërkesës;

- f) tregon kur është e zbatueshme, se kërkesa është objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar në përputhje me ligjin “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- g) tregon kur është e zbatueshme, se kërkesa është objekt i konsultimeve ndërkufitare;
- h) tregon që AKM është përgjegjëse për marrjen e vendimit për kërkesën dhe tregon natyrën llojin e mundshëm të vendimit, si dhe se të gjitha mundësitë janë të hapura;
- i) sipas rastit, hollësitë në lidhje me rishikimin dhe përditësimin e kushteve të lejes;
- j) tregon se ku dhe si mund të njihet me përmbajtjen e kërkesës dhe cdo informacion tjetër përkatës, përfshirë raportet kryesore dhe sipas rastit informacione, kohën kur do të jetë i disponueshëm për shqyrtim dhe se mund të shqyrtohet pa pagesë;
- k) tregon që çdo person i interesuar për të komentuar mbi kërkesën për leje mjedisi ose për të pyetur mbi këtë kërkesë, mund ta bëjë këtë me shkrim ose në rrugë elektronike në AKM brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Njoftimi tregon edhe adresën e AKM-së.

Seksioni 2

Konsultimi publik për kërkesën për leje mjedisi të tipit A dhe B

1. Njësia e qeverisjes vendore (bashkia apo komuna) në territorin e së cilës ndodhet instalimi, sapo merr një kopje të Formularit të kërkesës për leje mjedisi të tipit A dhe/ose B të njëjtë me atë që shfaqet në regjistrin publik të AKM, e vë atë menjëherë në dispozicion të antarëve të publikut në zyrat e njësisë së qeverisjes vendore gjatë orarit zyrtar.
2. Çdo anëtar i publikut ka të drejtë të konsultojë Formularin e kërkesës për leje mjedisi të tipit A dhe B në zyrat e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse pa pagesë.
3. Çdo anëtar i publikut ka të drejtë të kërkojë një kopje të Formularit të kërkesës për leje mjedisi të tipit A dhe/ose B nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse pa pagesë.
4. Çdo anëtar i publikut mund të bëjë komente me shkrim ose në mënyrë elektronike mbi kërkesat për leje mjedisi të tipit A dhe/ose B në adresën e AKM-së.
5. Çdo koment referuar paragrafit 4 duhet të bëhet brenda 20 ditëve nga shfaqja e njoftimit në gazeta.

KREU VI

PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT C

Seksioni 1

Kërkesat e posaçme për përcaktimin e kushteve të lejeve të mjedisit të tipit C

1. Leja e mjedisit e tipit C për cdo instalim përmban:
 - a) Vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, në mënyrë të veçantë ato të listuara në shtojcën 2 të ligjit për lejet e mjedisit, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi. Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë;
 - b) Kushte, të cilat sigurojnë mbrojtjen e tokës në qoftë se është e nevojshme;
 - c) Kushte, të cilat sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore në qoftë se është e nevojshme;
 - d) Kushte, të cilat sigurojnë menaxhimin e përshtatshëm të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi në qoftë se është e nevojshme;
 - e) Kërkesën që operatori të informojë rregullisht njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, ARM-në përkatëse dhe ISHM, mbi të dhënat e monitorimit të shkarkimeve nga ai instalim;
 - f) Kërkesën që operatori të informojë pa vonesë ARM-në përkatëse dhe ISHM për çdo incident ose aksident që ndikon apo mund të ndikojë ndjeshëm mjedisin;
 - g) kushte të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Seksioni 2
Shqyrtimi i kërkesës për leje mjedisi të tipit C

1. QKL brenda 1 dite pas marrjes së kërkesës për leje mjedisi të tipit C, e përcjell në mënyrë elektronike në ARM e cila njofton menjëherë me shkrim kërkuesin për marrjen në rregull të kërkesës.
2. ARM brenda 1 ditë nga marrja e kërkesës për leje mjedisi nëpërmjet QKL, dërgon një kopje të kërkesës në organet dhe institucionet në nivel lokal, duke theksuar edhe afatin prej 3 ditësh për dërgimin e komenteve të tyre.
3. ARM brenda 2 ditësh nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit C, në qoftë se e konsideron të nevojshme, nëpërmjet QKL, mund t'i kërkojë me shkrim kërkuesit informacione të tjera shtesë. Në kërkesë përcaktohen arsyeja ose arsyet përse kërkohet ky informacion.
4. Kërkuesi dërgon informacionin shtesë të kërkuar sipas paragrafit 3 në ARM, brenda pesë ditëve nga marrja e kërkesës. Kërkuesi i lejes së mjedisit të tipit C dhe ARM, mund të zgjatin këtë afat në qoftë se bien dakord me shkrim mes tyre.
5. ARM e konsideron kërkesën për leje mjedisi, si të tërhequr nga vetë kërkuesi dhe, nëpërmjet QKL informon kërkuesin me shkrim, në qoftë se nuk dërgon informacionin shtesë të kërkuar referuar pikës 3, brenda periudhës kohore referuar në pikën 4.
6. ARM pas marrjes së informacionit shtesë të përcaktuara në paragrafin 3 duhet të dërgojë menjëherë këtë informacion tek autoritet referuar në paragrafin 2 të këtij Seksioni.
7. ARM dhe autoritetet e përcaktuara në paragrafin 2 më sipër, brenda ___ditësh nga marrja e kërkesës për leje mjedisi mund të inspektojnë instalimin dhe/ose vendodhjen e tij për të verifikuar çdo informacion të dhënë nga kërkuesi. Autoritetet në nivel lokal të përcaktuar në paragrafin 2, në përputhje me fushën e tyre të kompetencave i japin komente ARM-së në mënyrë elektronike brenda 3 ditëve nga data e përcaktuar në paragrafin 2.
8. ARM konsideron se autoritetet e përcaktuara në paragrafin 2 më sipër nuk kanë komente për kërkesën, në qoftë se nuk dërgojnë komentet e tyre për kërkesën për leje mjedisi në ARM brenda afatit të përcaktuar.

SEKSIONI 3
Verifikimi i informacionit dhe lëshimi i lejes së mjedisit të tipit C

1. ARM verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga Kërkuesi në kërkesën e tij për leje mjedisi.
2. ARM vendos të japë ose jo lejen e mjedisit të tipit C duke përcaktuar kushte të detajuara të cilat lëshohen nga QKL.
3. ARM kryen procedurën sipas përcaktimit të pikës 1 brenda ___ dite nga data kur ka informuar kërkuesin për marrjen në rregull të kërkesës për leje mjedisi të tipit C.
4. Periudha kohore e përcaktuar në pikën 3 mund të zgjatet për aq kohe sa ARM dhe kërkuesi bien dakord me shkrim mes tyre, por në asnjë rast shtyrja nuk mund të zgjasë më shumë se ___ditë.
5. ARM për marrjen e vendimit merr parasysh komentet e marra brenda periudhës së përcaktuar, nga autoritetet referuar në pikën 2, të Seksionit 2 të këtij Kreu.
6. Pas marrjes së vendimit ARM informon QKL, e cila ia përcjell kërkuesit vendimin, me shkrim brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit. Vendimi i refuzimit të kërkesës për leje mjedisi të tipit C, përmban të gjitha shkaqet për refuzimin e tij.
7. Në rastin kur miraton kërkesën për leje mjedisi të tipit C, ARM-ja dërgon një kopje në formë elektronike të lejes në QKL, e cila informon kërkuesin.
8. ARM-ja komunikon me QKL dhe lëshimi i lejes së mjedisit bëhet nga QKL e cila e publikon në Rregjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licensave.
9. ARM, brenda 1 dite nga lëshimi i lejes nga QKL i dërgon informacionin mbi dhënien e Lejes njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe institucioneve të konsultuara.
10. ARM regjistron lejet e dhëna në bazën e të dhënave për lejet.

KREU VII
TRANSFERIMI I LEJEVE TË MJEDISIT

Seksioni 1
Transferimi i Lejeve të Mjedisit

1. Për transferimin e lejes përkatëse të mjedisit për një instalim të tipit A ose B, operatori i këtij instalimi dhe personi fizik apo juridik, te cilit kërkohej t'i transferohet leja, bëjnë një kërkesë të përbashkët në AKM për këtë transferim.
2. Kërkesa referuar në pikën 1, shoqërohet nga leja ekzistuese e mjedisit e tipit A ose B, sipas rastit, dhe përmban:
 - a) emrin, adresën dhe të dhëna të tjera identifikuese të operatorit;
 - b) emrin, adresën dhe të dhëna të tjera identifikuese të personit tjetër fizik apo juridik të referuar në pikën 1.
3. AKM merr vendimin për transferimin e lejes brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës ose brenda një periudhe më të gjatë për të cilën arrihet një marrëveshje me shkrim ndërmjet AKM dhe kërkuësve.
4. AKM, kur e konsideron të nevojshme për vlerësimin e kërkesës për transferimin e lejes përkatëse, kërkon me shkrim informacion shtesë nga operatori i instalimit ose personi tjetër fizik apo juridik referuar në pikën 1 të këtij Seksioni. Kjo kërkesë specifikon arsyen ose arsyet përse kërkohej informacioni shtesë dhe periudhën kohore, brenda të cilit ai duhet t'i jepet AKM.
5. Kërkesa për transferim konsiderohet si e tërhequr nga vetë kërkuësi, në qoftë se informacioni shtesë referuar në pikën 4, nuk jepet prej tyre brenda periudhës kohore të përcaktuar në kërkesën përkatëse të AKM. AKM informon kërkuësin për këtë vendim.
6. AKM i jep mendim të argumentuar me shkrim Ministrisë për transferimin ose jo të lejes me kushte të detajuara, brenda ____ ditëve pasi ka arritur në përfundimet e saj.
7. Ministri brenda 2 ditëve firmos aktin e miratimit të transferimit të lejes së mjedisit.
8. AKM i përcjell elektronikisht QKL dokumentat për refuzimin ose miratimin e kërkesës për transferimin e lejes së mjedisit.
9. QKL lëshon lejen e mjedisit dhe brenda ____ ditëve e publikon lejen e transferuar në Rregjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licensave dhe njofton Ministrinë/AKM.
10. Dispozitat e paragrafëve nga 1 deri 9 të këtij Seksioni zbatohen edhe për transferimin e lejes së mjedisit të tipit C. Në zbatim të këtij paragrafi fjalët "leje mjedisi e tipit A ose leje mjedisi e tipit B", lexohen "leje mjedisi e tipit C" dhe fjalët "Agjencia Kombëtare e Mjedisit" lexohen "Agjencia Rajonale e Mjedisit".

KREU VIII
Dispozita të fundit

Akte nënligjore të Ministrisë

Ngarkohet Ministri të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të këtij vendimi për të përshkruar në mënyrë të detajuar e të thjeshtëzuar procedurat që duhen ndjekur deri në lëshimin e lejeve të mjedisit.

Zbatimi

Ministria, AKM /ARM, ISHM dhe QKL ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

Shfuqizime

Udhëzimi i Ministrit nr.4, datë 15.4.2013 “Për dokumentacionin e aplikimit për leje mjedisi të tipit A, B dhe C në Qendrën Kombëtare të Liçencimit”, shfuqizohet pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA